

VENDIM
Nr. 18, datë 3.4.2013

PËR LICENCIM PËR HERË TË PARË SHA UJËSJELLËS KANALIZIME FUSHË-KRUJË

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencim për herë të parë operatorit sh.a. ujësjellës-kanalizime Fushë-Krujë me:
 - drejtues ligjor, Durim Roda
 - drejtuese teknike, Entela Muha
2. Operatori sh.a. UK Fushë-Krujë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
 - Kategoria A për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - Kategoria C për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e mbulimit të këtij operatori është bashkia Fushë-Krujë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare deri më 2.4.2017.

KRYETARI
Avni Dervishi